



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT
TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 482 Prot.

Tiranë, më 20.1.2021

Lënda: Raporti i monitorimit të performancës së produkteve të buxhetit të ILDKPKI për vitin 2020.

Drejtuar: **Z. Oltjon MUZAKA**
NËPUNËS I PARË AUTORIZUES
MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË

TIRANË

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, në zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2020, është mbështetur në kërkesat më të domosdoshme institucionale, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr.9049, datë 10.4.2003, "Për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive, të Detyrimeve Financiare të të Zgjedhurve dhe të Disa Nëpunësve Publikë", i ndryshuar, ligji nr.9367, datë 7.4.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike". i ndryshuar, si dhe ligji nr. 60/2016, datë 2.6.2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", i ndryshuar, duke paraqitur një realizim të shpenzimeve buxhetore për këtë periudhë, si më poshtë vijon;

Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, në mbështetje të ligjit nr. 99/2018 "Për Buxhetin e vitit 2020", i ndryshuar, Udhëzimit nr.2, datë 20.1.2020, "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020" dhe Aktit Normativ nr.15, datë 15.4.2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.99/2018 "Për Buxhetin e vitit 2020" i ndryshuar, shkresës nr. 4402 prot., datë 27.2.2020 "Për miratimin e detajimit të fondit të veçantë për vitin 2020" dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 25.11.2020 "Për rishpërndarje fondesh në buxhetin e vitit 2020 ndërmjet Ministrive dhe Institucioneve Buxhetore", nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, i është akorduar fondi buxhetor prej 142 milion e 650 mijë lekë, i cili përbëhet nga:

Fondi i Pagave 103 milion e 860 mijë lekë (zëri 600)

Fondi i Sigurimeve Shoqërore: 15 milion e 400 mijë lekë (zëri 601)

Fondi për Shpenzime Operative: 21 milion lekë (zëri 602)

Fondi për Investime: 2 milion lekë (zëri 231)

Transferime korrente: 390 mijë lekë (zëri 606)

Buxheti është akorduar për programin *“Menaxhim, Administrim, Planifikim”* dhe është i mbështetur në Deklaratën e Politikës të hartuar gjatë procesit të PBA 2020-2022, për realizimin e misionit të ILDKPKI, i cili kërkon një menaxhim efektiv të fondeve buxhetore të akorduara, në funksion të përcaktimit të rregullave për deklarimin dhe kontrollin e pasurisë, të legjitimitetit të burimeve të krijimit të saj, detyrimeve financiare për të zgjedhurit, nëpunësit publikë dhe për personat e lidhur me ta, grantimin e një vendimmarrje të paanshme, transparente, në interesin më të mirë të mundshëm të publikut e të besimit të tij ndaj institucioneve publike, nëpërmjet parandalimit të konfliktit ndërmjet interesave publike dhe atyre private të zyrtarëve në ushtrimin e funksioneve të tyre, si edhe parandalimin dhe goditjen e korrupsionit në sektorin publik dhe privat, nëpërmjet mekanizmit të sinjalizimit.

Referuar buxhetit të vitit 2020, ILDKPKI, në mbështetje të burimeve financiare në dispozicion, ka realizuar objektivat e planifikuara, në funksion të përmirësimit tërësor të infrastrukturës institucionale, në drejtim të rritjes së cilësisë së kontrollit të interesave private. Në respektim të rekomandimeve të dhëna, fondi i planifikuar buxhetor është vendosur në funksion të objektivave për forcimin e mëtejshëm të hetimit administrativ, të deklarimit të kontrollit të interesave private për subjektet që mbartin detyrimin për deklarim dhe personat e lidhur me ta.

Inspektorati i Lartë, për vitin 2020, në realizimin e shpenzimeve buxhetore, është mbështetur në një shpërndarje sa më racionale të kërkesave, të harmonizimit të nevojave të ILDKPKI me burimet financiare në dispozicion, me qëllim zbatimin e politikave buxhetore përmes përdorimit ekonomik dhe eficient të burimeve financiare, për realizimin e objektivave prioritare si;

- Drejtimi dhe përmirësimi i politikave dhe mekanizmave për kontrollin e vërtetësisë dhe saktësisë së pasurive, të parandalimit dhe shmangies së konfliktit të interesave të zyrtarëve që ushtrojnë funksione publike, si instrumente të rëndësishme për luftën kundër korrupsionit.
- Forcimi i mëtejshëm i teknikave të hetimit administrativ jo vetëm në identifikimin e pasurive të fshehura apo të padeklaruara, por sidomos në kryerjen e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm të rasteve të konfliktit të interesave.
- Hetimi mbi pasuritë dhe burimin e të ardhurave të personave jo zyrtarë që kanë interesa të përbashkëta me subjektin deklarues dhe forcimi i punës për zbulimin e rasteve të fshehjes apo deklarimit të rremë të zyrtarëve që abuzojnë me pushtetin.
- Parandalimi i rasteve të pasurimit në rrugë abuzive të zyrtarëve dhe të personave të lidhur me ta.
- Parandalimi i rasteve të konfliktit rast pas rasti apo të vazhdueshëm të interesave të zyrtarëve që ushtrojnë funksione publike.
- Penalizimi i rasteve të abuzimit nga zyrtarët me funksionet e tyre publike.

- Parandalimi dhe goditja e korrupsionit në sektorin publik e privat nëpërmjet hetimit administrativ të sinjalizimit të brendshëm e të jashtëm dhe mbrojtjen e individëve që sinjalizojnë për veprime dhe praktika të dyshuara të korrupsionit, nga hakmarrja në përputhje me ligjin nr. 60/2016, datë 2.6.2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, i ndryshuar.

Nga fondi i përgjithshëm buxhetor, në zbatim të ligjit nr. 99/2018, “Për Buxhetin e vitit 2020”, për periudhën e raportuar, Inspektorati i Lartë ka realizuar vlerën buxhetore në shumën 135,486,144.70 lekë ose 95%, të fondit të planifikuar për 12 mujorin e vitit 2020.

Llog Ek	Përshkrimi	Plan-Buxheti vjetor 2020 i Rishikuar	Buxheti i realizuar viti 2020	Realizimi në % viti 2020
600	Fond Page	103.860,00	102.487,00	98,7%
601	Kontrib.Sig Shoq & Shend	15.400,00	14.301,00	92,9%
602	Shpenzime operative	21.000,00	16.711,00	79,6%
606	Transferta per financime te tjera	390,00	240,00	61,5%
231	Investime	2.000,00	1.747,00	87,4%
Shuma		142.650,00	135.486,00	95,0%

✚ Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore (zëri 600-601)

Fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore është realizuar në zbatim të strukturës organizative të miratuar. Për 12-mujorin e vitit 2020, numri i punonjësve është realizuar 70 vetë, nga 70 vetë të miratuar. Me Vendim të Këshillit të Ministrave nr.47, datë 22.1.2020, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2020, në njësitë e qeverisjes qendrore”, për shkak të nevojave të institucionit, është miratuar një punonjës me kontratë të përkohshme deri në fund të vitit 2020.

Fondi i përgjithshëm i pagave dhe i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për këtë periudhë, është realizuar për numrin faktik të punonjësve në vlerën **102,487,388** lekë ose **98.7%** e fondit të planifikuar për periudhën respektive dhe për kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në vlerën **14,301,181** lekë ose **92.9%**, e fondit të planifikuar për periudhën respektive.

✚ Fondi për shpenzime në zërin investime (zëri 231)

Gjithsej fondi i planifikuar i investimeve për vitin 2020 ishte 2 milion lekë dhe është realizuar prokurimi në vlerën 87.4% e fondit të planifikuar për vitin 2020.

Inspektorati i Lartë, në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi dhe të planifikimit në Regjistrin e Parashikimeve të Prokurimeve Publike të vitit 2020, për periudhën e raportimit, ka prokuruar fondet e planifikuara të vëna në dispozicion nga buxheti i shtetit si më poshtë;

1. Fondi i planifikuar i investimit i miratuar si produkt nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me objekt “Blerje Pajisje Elektronike” me fond limit 1,166,667 (një milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh është prokuruar me procedurën kërkesë për propozim dhe është fituar nga

shoqëria "BNT ELECTRONICS" Shpk, në vlerën 1,059,600 (një milion e pesëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind) lekë pa tvsh ose 91% të fondit të planifikuar. Në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, likujdimi është kryer në zbatim të kontratës dypalëshe nr.2592 prot, datë 18.8.2020.

2. Fondi i investimeve i miratuar si produkt nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me objekt "Orendi Zyre të Blera", me fond limit 500,000 (pesëqind mijë) lekë pa tvsh është prokuruar me procedurën blerje me vlerë të vogël dhe është fituar nga shoqëria "Xhezmi Siqeca" Shpk, në vlerën 396,000 (treqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë) lekë pa tvsh ose 79.2% të fondit të planifikuar. Në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, likujdimi është kryer pas marrjes në dorëzim të furnizimeve, orendi zyre, sipas sasisë dhe specifikimeve teknike në ftesën për ofertë.

↓ Fondi për shpenzime në zërin Mallra dhe Shërbime (zëri 602)

Realizimi për grupin e shpenzimeve operative për vitin 2020 është gjithsej në vlerën **16,710,855.70** lekë me tvsh, ose **79.6%** e fondit të planifikuar për këtë periudhë, në respektim të dispozitave ligjore në fuqi.

Për vitin 2020, realizimi në grupin e shpenzimeve operative është mbështetur duke respektuar dispozitat ligjore në fuqi. Diferencat në vlerë përbëjnë kursime gjatë procesit të prokurimit, të cilat janë rishpërndarë sipas nevojave më të domosdoshme të institucionit.

1. Shërbimi i ruajtjes me roje civile është vazhdim i Marrëveshjes Kuadër me operatorin ekonomik fitues "Trezhnjeva" sh.p.k, me objekt "Shërbimi i ruajtjes me roje civile" për godinën e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 12 muaj, nga momenti i nënshkrimit të marrëveshjes kuadër me nr. 2951/1 prot, datë 3.5.2019. Është likjuar marrëveshja kuadër në përputhje me parashikimet ligjore në vlerë 1,273,567.92 (një milion e dyqind e shtatëdhjetë e tre mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë me tvsh.
2. Fondi i parashikuar për grup artikullin "Blerje materiale kancelarie", me fond limit për 666,667 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh, është realizuar me procedurën e blerjes me vlerë të vogël dhe është fituar nga operatori ekonomik "Infosoft Office" sh.p.k në vlerën 629,100 (gjashtëqind e njëzetë e nëntë mijë e njëqind) lekë pa tvsh ose 94% e fondit të planifikuar. Likujdimi është kryer konform specifikimeve teknike të kërkuara.
3. Fondi i parashikuar për grup artikullin "Blerje materiale pastrimi", me fond limit 416,667 (katërqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë)

lekë pa tvsh, është realizuar me procedurën e blerjes me vlerë të vogël dhe është fituar nga operatori ekonomik "XH-N-SH GROUP" sh.p.k në vlerën 315,000 (treqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë pa tvsh ose 76% e fondit të planifikuar. Likujdimi është kryer konform specifikimeve teknike të kërkuara.

4. Fondi i parashikuar për grup artikullin "*Mirëmbajtje dhe shërbime software (sistemi HIDAACI)*" u prokurua gjatë muajit Shkurt 2020 me procedurën e prokurimit "Tender i Hapur", me fond limit 66,666,667 (gjashtëdhjetë e gjashtë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, me numër reference të procedurës/lotit REF-51984-02-28-2020. Në zbatim të Aktin Normativ nr.3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, "*Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19*", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 243, datë 24.3.2020 "*Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore*" pika 6, Vendimit të Komitetit Ndërmintor të Emergjencave Civile nr.1, datë 25.3.2020 "*Për konfirmimin dhe vijimin e zbatimit të masave të veçanta administrative të marra gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19*" dhe Njoftimit nr. 2371 prot, datë 31.3.2020 të Agjencisë së Prokurimit Publik, kjo procedurë u pezullua. Me shfuqizimin e pezullimit të procedurave të prokurimit nga APP, procedura është hapur më 2.9.2020. Pas procesit të vlerësimit dhe zbatimit të afateve ligjore, fitues janë bashkimi i operatorëve ekonomikë "IkubINFO" sh.p.k & "Infosoft Systems" sh.p.k , në shumën 64,666,670 (gjashtëdhjetë e katër milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë) lekë pa tvsh ose 97% e fondit të planifikuar. U lidh kontrata me BOE "IkubINFO" sh.p.k & "Infosoft Systems" sh.p.k me nr.2968 prot, datë 2.11.2020, me afat zbatimi 48 muaj nga nënshkrimi i kontratës. Likujdimi është periodik mujor sipas përcaktimeve në kontratën e nënshkruar midis palëve.
5. Fondi i parashikuar për grup artikullin "*Shërbim riparim/mirëmbajtje për 3 automjetet e ILDKPKI*", me fond limit 500,000 (pesëqind mijë) lekë, pa tvsh, është realizuar me procedurën e blerjes me vlerë të vogël dhe është fituar nga shoqëria "*Servis –Auto 2000*" sh.p.k në vlerën 443,650 (katërqind e dyzet e tre mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lekë pa tvsh ose 88,7% e fondit të planifikuar. Likujdimi është kryer konformë specifikimeve teknike të kërkuara.
6. Fondi i parashikuar për grup artikullin "*Blerje Karburant*", me fond limit për 666,667 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh është realizuar me procedurën e blerjes me vlerë të vogël dhe është fituar nga shoqëria "*Gega Center GKG*" sh.p.k në vlerën 560,029 (pesëqind e gjashtëdhjetë mijë e njëzet e nëntë) lekë pa tvsh ose 84% e fondit të planifikuar. Likujdimi është kryer konformë specifikimeve teknike të kërkuara dhe kushteve të përcaktuara në kontratën dypalëshe nr. 2546 Prot., datë 3.8.2020.
7. Fondi i parashikuar për grup artikullin "*Blerje tonera për printera dhe fotokopje*", me fond limit për 1,250,000 (një milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa tvsh

është realizuar me procedurën e prokurimit kërkesë për propozim dhe është fituar nga operatori ekonomik, shoqëria "Infosoft Office" sh.p.k në vlerën 841,917 (tetëqind e dyzet e një mijë e nëntëqind e shtatëmbëdhjetë) lekë pa tvsh ose 67.4% e fondit të planifikuar. Likujdimi është kryer konformë specifikimeve teknike të kërkuara dhe kushteve të përcaktuara në kontratën dypalëshe nr.3201 prot, datë 16.12.2020.

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar në përmbushjen e detyrimeve me shtetin shpenzime si posta, energji, ujë, telefoni. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe janë lidhur kontrata shpenzim i abonimit në shtyp, siguracione të detyrueshme për automjetet e ILDKPKI, kontrata e shërbimit të mirëmbajtjes së ashensorit, larjes së automjeteve etj, të cilat institucioni i ka likujduar në mbështetje të specifikimeve teknike të sanksionuara në marrëveshjet dypalëshe.

Përsa i përket shpenzimeve për blerje mallra të natyrave të ndryshme, institucioni për këtë periudhë, i ka prokuruar dhe realizuar sipas nevojave konkrete, në mbështetje të dispozitave ligjore në fuqi.

Realizimi i prokurimeve të shpenzimeve të planifikuara për ILDKPKI, për vitin 2020, është mbështetur në Regjistrin e Parashikimeve të Prokurimeve Publike të vitit 2020, të publikuar dhe kërkesave konkrete të institucionit, të kërkesave për përmirësimin e mëtejshëm të punës në menaxhimin dhe zbatimin e objektivave të përcaktuara, duke zbatuar me korrektësi të gjitha detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni financiar nëpërmjet një administrimi korrekt dhe kontrolli të vazhdueshëm.

↓ Realizimi i të ardhurave nga veprimtaria e ILDKPKI

Të ardhurat nga veprimtaria e ILDKPKI, vijnë kryesisht nga;

- 1) Arkëtimi i gjobave të vendosura për rastet e shkeljes së detyrimeve ligjore, gjatë zbatimit të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 "Për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive, të Detyrimeve Financiare të të Zgjedhurve dhe të Disa Nëpunësve Publikë", i ndryshuar, ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funkcioneve Publike" i ndryshuar, si dhe ligjit nr.60/2016, datë 2.6.2016, "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", i ndryshuar, nga subjekte në sektorin publik dhe privat.
Për vitin 2020, janë gjithsej 13 raste të ekzekutuara me vullnet të lirë, në vlerën 2,465,000 lekë.
- 2) Ekzekutimi i detyrueshëm nga Zyrat Përmbare të rretheve për gjobat e vendosura për rastet e shkeljes së detyrimeve ligjore, si dhe vendimeve gjyqësore që kanë marrë formë të prerë. Për këtë periudhë vjetore janë ekzekutuar tërësisht gjithsej 36 raste, në vlerën 6,178,137.07 lekë.

Gjithsej të ardhurat të arkëtuara për vitin 2020, janë në vlerën 8.643.137.07 lekë.

Të gjitha këto të ardhura, të realizuara në zbatim të ligjeve organike, mbi të cilat funksionon Inspektorati i Lartë dhe të VKM nr.432, datë 28.6.2006 "Mbi të ardhurat në Institucionet Buxhetore", kanë kaluar në Buxhetin e Shtetit në masën 100%.

ILDKPKI, në vijim do të vazhdojë të ndjekë një politikë menaxhuese efektive, të fondeve buxhetore të akorduara, në drejtim të shpenzimeve të miratuara vjetore, duke mundësuar zbatimin efektiv të objektivave të institucionit, në funksion të një vendimmarrjeje transparente në kontrollin e deklarimit të pasurive, ligjshmërinë e burimeve të krijimit, detyrimeve financiare për të zgjedhurit, nëpunësit publikë, për familjarët dhe personat e lidhur me ta, nëpërmjet parandalimit të konfliktit të interesave të zyrtarit, në ushtrimin e funksioneve publike, si dhe arritjen e standarteve më të mira bashkëkohore.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Evgjeni BASHARI




No.482/ Prot.

Dt. 20.01.2021

ANEKSI nr.1 "Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve"

ne 000/leke

Emri i Grupit		Inspektorati I Larte I Deklarimit dhe Kontrollit te pasurive dhe Konfliktit te Interesave					Kodi i Grupit		76	
Programet		Shpenzimet e Inspektoratit te Larte te Deklarimit dhe Kontrollit te Pasurive dhe Konfliktit te Interesave								
		(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)=(6)-(5)		
		Fakti	PBA	Buxheti Vjetor	Buxheti Vjetor	Buxheti 12-Mujor	Fakti	Diferenca		
Titulli	Emertimi	I Viti 2019	Viti 2020	Plan Fillestar Viti 2020	Plan i Rishikuar Viti 2020	Plani i Periudhes 12-mujore/progresiv	i Periudhes- 12 -mujore/progresiv			
01110	Planifikim, Menaxhim,Administrim	133.473,3	158.500,0	158.500,0	142.650,0	142.650,0	135.486,0	-7.164,0		
Totali i Shpenzimeve të ILDKPKI		133.473,3	158.500,0	158.500,0	142.650,0	142.650,0	135.486,0	-7.164,0		
Shpenzime nga të Ardhurat Jashtë limitit										
Totali		133.473,3	158.500,0	158.500,0	142.650,0	142.650,0	135.486,0	-7.164,0		

Sekretari i Përgjithshëm	Emri	Evgeni BASHARI
	Firma	
	Data	




Nr. 482/2 Prot.

Dt. 20.01.2021

ANEKSI nr.2 "Raporti i Shpenzimeve të Programit sipas Shpenzimeve"

ne 000/leke

Emri i Grupit		ILDKPKI					Kodi i Grupit	1076001
Programi							Kodi i Programit	01110
Art.	Emertimi	(1) Fakti i vitit paraardhes Viti 2019	(2) PBA Plan Viti 2020	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2020	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2020	(5) Buxheti Vjetor Plani i Periudhes- 12 muajore/progresiv	(6) Fakti i Periudhes- 12 - muajore/progresiv	(7)=(6)-(5) Diferenca
600	Paga	101.430,02	104.860,0	104.860,0	103.860,0	103.860,0	102.487,0	-1.373,0
601	Sigurime Shoqërore	14.027,4	15.400,0	15.400,0	15.400,0	15.400,0	14.301,0	-1.099,0
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	16.665,0	36.000,0	36.000,0	21.000,0	21.000,0	16.711,0	-4.289,0
603	Subvencione							0,0
604	Transferta Korente të Brendshme							0,0
605	Transferta Korente të Huaja							0,0
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	289,4	240,0	240,0	390,0	390,0	240,0	-150,0
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	132.411,8	156.500,0	156.500,0	140.650,0	140.650,0	133.739,0	-6.911,0
230	Kapitale të Patrupëzuara							0,0
231	Kapitale të Trupëzuara	1.061,5	2.000,0	2.000,0	2.000,0	2.000,0	1.747,0	-253,0
232	Transferta Kapitale							0,0
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	1.061,5	2.000,0	2.000,0	2.000,0	2.000,0	1.747,0	-253,0
230	Kapitale të Patrupëzuara							0,0
231	Kapitale të Trupëzuara							0,0
232	Transferta Kapitale							0,0
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
Totali	Shpenzime Kapitale	1.061,5	2.000,0	2.000,0	2.000,0	2.000,0	1.747,0	-253,0
Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti		0,0					0,0	
Totali (korrente + kapitale + Shp nga te ardh.jashte limiti)		133.473,3	158.500,0	158.500,0	142.650,0	142.650,0	135.486,0	-7.164,0

Drejtesuesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Emri. Miranda Porja	Sekretari i Përgjithshëm	Emri	Evgjenti Bashari
	Firma		Firma	
	Data		Data	



No. 482 / 3 Prot.

Dt. 22.01.2021

ANEKSI nr.3 "Raport përmblidhës i realizimit të kërkesave të performancës/produkteve të programit"

Emri i Grupit	S.DKPN	Kodi i Grupit	IS16691
Programi	Planifikim, Monitorim, Administrim	Kodi i Programit	01110

Kodi	Emertimi i Treguesit të Performancës/Produktit	Njësia matëse	Sasia Faktive (2019)	Shpenzimet (2019)	Kosto per Njese (2019)	I		II		III		IV		Luhatjet ne Koston per Njese			Komente	
						Sasia (sipas planit te vitit 2020)	Shpenzimet (sipas planit te vitit 2020)	Kosto per Njese (sipas planit te vitit 2020)	Sasia (sipas planit te realizuar te vitit 2020)	Shpenzimet (sipas planit te realizuar te vitit 2020)	Kosto per Njese (sipas planit te realizuar te vitit 2020)	Sasia Faktive (ne Fund te vitit 2020)	Shpenzimet Faktive (2020)	Kosto per Njese Faktive (ne fund te vitit 2020)	V = IV - I	V = IV - II		V = IV - III
A	Shërbje Pajisje Elektronike	copë	14	1.061	76	16	1.400	140	15	1.400	93,3	15	1.400	93,3	18	-47	0	realizuar
B	Orizzali nye te Mena	copë				21	600	28,6	31	600	19,4	31	600	19,4	12	-9	0	realizuar

Treguesit e Performancës/Produktet e realizuara nga perdonimi i te ardhurave jashte limitit

Kodi	Emertimi i Treguesit të Performancës/Produktit	Njësia matëse	Sasia e realizuar	Fakti i perulimit/progresiv	Komente
A	Produkt			0,0	mb ke
B	Treguesit e Performancës			0,0	

Drejtori i Ekspert Marachues te Programit	Emri	Miranda Peci	Subskritur / Përgjigjës	Emri	Edi Dusha
	Firma			Firma	
	Data			Data	



Nr. 482/4 Prot.

Dt. 22.01.2021

ANEKSI nr.5 "Projektet e investimeve me financim te brendshem dhe me financim te huaj"


Projektet me financim te brendshëm (ne 000/leke)

ne 000/leke

Kodi projektit	Emertimi i projektit	Vlera e plotë e projektit	Viti i fillimit të projektit	Viti i përfundimit të projektit	Buxheti 2020 Kontraktuar	Plani i buxhetit viti 2020	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i vitit deri në periudhën aktuale	REALIZIMI për periudhën e raportimit (12-mujore/vjetore)	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i projektit deri në periudhën aktuale	Komente
M760038	Blerje Pajisje Elektronike	1.400	2020	2020		1.400	1.272	1.272		Realizuar
M760029	Orendi zyre të blera	600	2020	2020		600	475	475		Realizuar
		2.000				2.000	1.747	1.747		

Projektet me financim te huaj (ne 000/leke)

Kodi projektit	Emertimi i projektit	Grant/ Kredi	Vlera e plotë e projektit	Viti i fillimit të projektit	Viti i përfundimit të projektit	Buxheti 2020 Kontraktuar	Plani i buxhetit viti 2020	REALIZIMI për periudhën e raportimit (4-mujore/vjetore)	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i vitit deri në periudhën aktuale	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i projektit deri në periudhën aktuale	Komente
											ILDKPKI nuk ka projekte me financim te huaj per vitin 2020

Drejtuessi i Ekipit Menaxhues të Programit	Emri	Miranda Porja	Sekretari i Përgjithshëm	Emri	Evgjeni Bafhari
	Firma			Firma	
	Data			Data	

